

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

Për Aktivitetin e Prokurimit: 207-25-7067-5-1-1

Nr i brendshëm: 207-25-086-511

Sa i përket tenderit për: Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në Xhaminë e Çokut në Junik dhe Xhaminë e Orllanit në Podujevë – LOT 2

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

TONI O.P.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Kërvasari

(Adresa)

Malishevë

24 000

(Vendi)

(Kodi postar)

049 855 318

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Naim BYTYÇI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@toni-ks.com

(Adresa elektronike)

12.02.2026

(Data)



(nënshkrimi)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. Njoftim per Kontrat 04.08.2025
2. Proces verbali i hapjes se Tenderve 01.09.2025
3. Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues 15.09.2025
4. Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues rivlersimi 01.10.2025
5. Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues rivlersimi 22.01.2026
6. Kerkesa per rishqyrtim: 26.01.2026
7. Vendimi i Kerkeses per rishqyrtim: 02.02.2026

8. Ankesa ne OSHP: 12.02.2026

9. Kriteri I perzgjedhjes: Cmimi me I ulet me dokumentacion te pergjegjshem.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☒				Jo	☐	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Hapja është bërë përmes platformes së E-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	☒				Jo	☐	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Jemi njoftuar përmes Vendimit të AK-se dhe Letrës standarde.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

- **Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjit Nr. 05/L-092,**

Shkeljet në këto nene:

Neni 1 Qëllimi,

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

- **Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr.002/2024 për Prokurimin Publik**

Shkeljet në këto nene:

Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi i Rregullores për Prokurimin Publik

Neni 27 Kriteret e Dhënies së Kontratës

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në mbështetje të nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ne operatori ekonomik "TONI O.P.", në cilësinë e palës me interes juridiko-material, parashtrojmë këtë ankesë kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 22.01.2026 dhe Vendimit mbi Kërkesen për Ri-shqyrtim të datës 02.02.2026, si palë e pakenaqr me ri-vlersimin e ofertave i paraqesim faktet dhe argumentet tona:

Kronologji e rrethanave dhe këtij aktiviteti të prokurimit:

- Kjo ankesë është e bazuar në vendimin nr. 2025/0006, të datës 17.03.2025, të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Pretendimi kryesor i yni në këtë ankesë ka të bëjë me çështjen e gjykuar një herë, në ankesën 2025/0006 të cilën kemi qenë palë me interes dhe njëkohësisht palë ankuuese. Kërkojmë nga OSHP që me vigjilencë, në mënyrë objektive dhe të pavarur, ta shqyrtojë këtë ankesë të kompanisë "TONI O.P.", dhe kjo ankesë të pranohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlersim, në të kundërtën do të jetë standard i dyfishtë dhe minim i sigurisë juridike.

- Njoftimi mbi vendimin e AK, të datës 15.09.2025, neve si OE na eliminon. Këtë vendim e kundërshtojmë me kërkesë për rishqyrtim, e njëjta merret e bazuar dhe me vendimin e datës 01.10.2025 ne rekomandohemi për kontratë.
- Parashtrajnë ankesa në OSHP operatorët “EING COM” Sh.P.K dhe “FRONI 1” Sh.P.K, me ankesat nr. 1000/2025 dhe 1012/2025. Eksperti shqyrtues devijon raportin, interpreton ligjin mbi marrëdhëniet dhe detyrimet si tërësi, por nuk mbështetet në asnjë bazë ligjore dhe, pa ia kërkuar askush, del jashtë kompetencave “ultra vires” dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.
- Vendimi i Panelit Shqyrtues, në lidhje me ankesat nr. 1000/2025 dhe 1012/2025, mbështet raportin e ekspertit që lënda të kthehet në rivlerësim, por pretendimet ankimore te OE ankues janë konstatuar si të paqëndrueshme dhe, rrjedhimisht, janë të papërgjegjshm.

Në lidhje me njoftimin mbi vendimin e AK të datës 22.01.2026:

- Operatori i rekomanduar për kontratë “EING COM” Sh.P.K., konsiderojmë se bazuar në faktet dhe argumentet, është i papërgjegjshëm nga ana administrative dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, Ligjin e Punës, si dhe me Ligjin nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Si dhe është në kundërshtim me vendimin nr. 2025/0006, të datës 17.03.2025, të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).
- Sa i perket operatorit “FRONI 1” Sh.P.K., konsiderojmë se bazuar në faktet dhe argumentet, është i papërgjegjshëm nga ana administrative dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, si dhe është në kundërshtim me vendimin nr. 2025/0006, të datës 17.03.2025, të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).
- Sa i përket eliminimit tonë, ne jemi eliminuar pa të drejtë. Arsyet e cekura në letrën standarde për eliminimin tonë janë të pasakta, diskriminuese dhe janë shabllon të arsyeve të cilat ishin dhënë në vendimin e datës 15.09.2025, të cilat i kemi kundërshtuar me kërkesën për rishqyrtim, ku kjo kërkesë është marrë si e bazuar nga vetë AK.
- Kërkesa jonë për rishqyrtim është refuzuar në mënyrë arbitrare nga AK, aspak e mbështetur ligjërisht dhe cenon të drejtën tonë konkurruese.

Pretendimi 1. Operatori i rekomanduar për kontratë “EING COM” Sh.P.K., në njoftimin e datës 22.01.2026, fillimisht i eliminuar në dy vendime paraprake të datave 15.09.2025 dhe 01.10.2025. Operatori rekomanduar është i papërgjegjshëm, për shkak se nuk i plotëson kriteret e Dosjes së Tenderit dhe është në kundërshtim me vendimin nr. 2025/0006, të datës 17.03.2025, të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), ku kriteret të cilat nuk i plotëson ky operator janë të trajtuara në këtë vendim ku ne kemi qenë palë ankuese dhe me interes, dhe është e qartë e pakontestueshme se operatori nuk është në pajtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit, konkretisht me kriteret:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	Kriteri numër 2. Caktimi i Menaxherit të kontratës Sistemi i menaxhimit 2. Vendimi për përcaktimin e menaxherit të kontratës, i cili duhet të jetë Master ose Inxhinier i Arkitekturës ose i Ndërtimtarisë-konstruktiv. Vendimi duhet të përmbajë të dhënat bazike mbi procedurën aplikuese (Emrin e Autoritetit, Emërtimin e procedurës, numrin e prokurimit). Menaxheri i kontratës duhet të prezantojë: a. Diplomën universitare. b. Kontratën e punës ose parakontrata (të nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). c. Dëshmi për përvojë të punës se paku 5 vite në fushën e trashëgimisë kulturore ose të punëve të ngjashme (të dëshmohet me CV të nënshkruar nga i angazhuari). d. Së paku një referencë të punës në menaxhim të kontratave – mbikëqyrje të implementimit të projekteve të ngjashme; Së paku njëri nga staffi i angazhuar, qoftë menaxheri i kontratës qoftë njëri prej inxhinjerëve nga lista e stafit profesional duhet të jenë të licencuar me licencë A1. Në rast të posedimit të Licencës A1, duhet të prezantohet vetëm kopja e licencës ose kopja e vendimit të Bordit të Licencimit që është i licencuar në kategorinë A1; Kontratën ose parakontratën me OE - të nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE; dhe së paku një referencë të punës në menaxhim të kontratave – mbikëqyrje të implementimit të projekteve të ngjashme.
---	---

		Kriteri numër 3. Lista e stafit profesional 3.1 Një (1) Inxhinier i diplomuar i arkitekturës (ose Master) 3.2. Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë/konstruktiv (ose Master) 3.3 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (ose Master) drejtimi hidroteknik 3.4 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës (ose Master) 3.5 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i makinerisë (ose Master)	3. E gjithë lista e stafit të kërkuar në kërkesën numër 2 nga Autoriteti kontraktues duhet të ketë: a. Diploma universitare. b. Kontrata e punës ose parakontrata (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). c. Dëshmi për përvojë të punës së paku 5 vite në fushën e trashëgimisë kulturore ose punë të ngjashme (të dëshmohet me CV të nënshkruar nga i angazhuari) për pikën 3.1 dhe 3.2; dëshmi për përvojë të punës së paku 2 vite në fushën e trashëgimisë kulturore ose punë të ngjashme (të dëshmohet me CV të nënshkruar nga i angazhuari) për pikën 3.3, 3.4 dhe 3.5. d. Dëshmi për së paku një referencë të punës që ndërlidhet me njërin nga natyrat e punës në restaurim ose konservim ose renovime të objekteve të trashëgimisë kulturore, përjashtimisht pikave 3.2, 3.3, 3.4 dhe 3.5 ku nuk kërkohet dëshmi.
--	--	--	--

Operatori i rekomanduar për kontratë është në kundërshtim me kriterin numër 2 dhe kriterin numër 3, përkatësisht me pikën 3.1.

Per faktin se nuk ka angazhuar arkitektë sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit. Në kriterin numër 2 kërkesa ka qenë që një Master ose Inxhinier i Arkitekturës ose i Ndërtimtarisë – konstruktiv të jetë i emëruar si Menaxher i Kontratës, ndërsa në kërkesën 3.1 është kërkuar një (1) Inxhinier i diplomuar i arkitekturës (ose Master), si kriter i vecant nga lista e stafi.

Bazuar në listën e stafit të ofruar në ofertë, në këtë pikë operatori i rekomanduar është në kundërshtim me kërkesat, pasi ka angazhuar vetëm një arkitekthe (sipas kërkesave ne DT), përkatësisht znj. Ilirjana Azizi Mejzini, dhe e ka emëruar si Menaxhere të Kontratës, dhe një arkitekt z. Zgjim Lepaja bachelor i arkitektures, por nuk është në përputhje me DT, sepse i mungon niveli përgaditjes master dhe provoja pas diplomimit. Mirëpo përmes tendencave në kërkesën për rishqyrtim dhe në ankesën e paraqitur në OSHP, operatori ka devijuar dhe anashkaluar qëllimin për të cilin ka qenë i eliminuar, respektivisht faktin se është eliminuar për shkak se nuk ka angazhuar arkitektë sipas kërkesës 3.1: Një (1) Inxhinier i diplomuar i arkitekturës (ose Master).

Në ankesë këtë pikë nuk e ka kundërshtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, por në një formë e ka pranuar. Megjithatë përmes arsyetimeve të dëshmive dokumentare lidhur me Menaxherin e Kontratës, ka interferuar dëshmitë e menaxherit edhe në listën e stafit profesional, përkatësisht në kriterin numër 3, duke devijuar nga kërkesat përkatëse, sic shihet më poshtë.

Komisioni i vlersimit të ofertave në menyra tendencioze dhe te padrejt na eliminon duke aluduar ne mos plotesim te kerkeseve te dosjes kur shihet qarte qe keto dokumente jane prezentuar dhe gjinden ne dosjen e dorezuar nga ana jon dhe se kerkesa e DT se tenderit ka qene shum e qarte:

Citat: Së paku njëri nga stafi i angazhuar, qoftë menaxheri i kontratës qoftë njëri prej inxhinjerëve nga lista e stafit profesional duhet të jenë të licencuar me licencë A1. Ne kemi prezentuar znj. Ilirjana Azizi Mejzini - Menaxhere e kontratës, si pjese se stafit me vendim me te gjitha te dhenat siq eshte kerkuar ne dosjen e tenderit, andaj AK ka kerkuar sqarim per plotesim dokumentacioni per dy persona si pjese te listes qe skan qene kerkese fare por ne i kemi lene ne list si staf mbeshtetes dhe ky vlersim dhe manipulim dhe shtremberim i fakteve eshte dukuri e perseritu tek AK sepse në vazhdimësi është duke perdor standarde te dyfishta me rastin e vlersimit te ofertave.

Refuzimi i kerkeses per rishqyrtim është bërë me pretekstin se Kriteri nr 2 sipas dosjes se tenderit ka kerkuar qe menaxheri i projektit te jete veq ndersa stafi te jene veq, por **NUK QENDRON** ky pretendim sepse te deshmia e kerkuar dokumentare eshte cekur qarte që: **Së paku njëri nga stafi i angazhuar, qoftë menaxheri i kontratës qoftë njëri prej inxhinjerëve nga lista e stafit profesional duhet të jenë të licencuar me licencë A1,** andaj AK ka perdor standarde te dyfishta sepse ne procedurat e zhvilluara paraprake nga ku autoritet ka vlersuar dhe nenshkruar kontrata me kerkesat e njejta ndersa ne rastin tone nxjerr vendim per eliminim ne kundeshtim me kerkesat e percaktuara nga vete AK dhe kjo shihet si tendence te vleresimit me standarde te dyfishta varesisht nga preferencat qe AK ka.

Pretendimi i operatorit të rekomanduar ka qenë se, përmes dëshmive dokumentare të Menaxherit të Kontratës, të plotësojë kriterin numër 3.1, ku citon: *“Së paku njëri nga stafi i angazhuar, qoftë Menaxheri i Kontratës, qoftë njëri prej inxhinjerëve nga lista e stafit profesional, duhet të jetë i licencuar me licencë A1.”* Kjo kërkesë është e përpiluar qartë dhe nënkupton se njëri nga arkitektët duhet të jetë i licencuar me licencë A1, përkatësisht Menaxheri i Kontratës (kriteri nr.2) ose Inxhinier i Arkitekturës nga lista e stafit profesional (kriteri nr.3), **pasi që sipas UA 02/2025 me licencë A1 mund të licencohet vetëm profesioni i Arkitektit.** Rrjedhimisht vete formulimi le t'kuptoj se janë kërkuar dy Arkitektë nivelit master, dhe njeri nga ta te jete i licensuar me A1, pasi që AK nuk ka kerkuar qe inxhinieri makinerise te jete i licensuar, sepse nuk është e mundur sipas UA 02/2025, profile tjera përvec Arkitektit të licensohen me këtë kategori.

Po ashtu operatori ka tentuar që edhe përmes emërimit të folderit që ka ngarkuar dhe formularit të tenderit të plotësojë kriteret:

Kundërshtim ndaj arsyes së eliminimit tonë sa i përket mos plotësimit të kriterit ne 2 mos ofrimit te sqarimeve sipas kerkeses se AK-se NUK QENDERON, sepse ne me rastin e ofrimit kemi ofruar te gjith stafin e nevojshem sipas kerkeses se DT i cili eshte i bashkangjitur me rastin e dorezimit te ofertes sone andaj kete fakt e keni te dokumentuar edhe sipas Formularit standard per dorezimin e ofertes: **11. 10. Lista e stafit profesional.pdf**

Por thelbi i kësaj cështjeje është se operatori i rekomanduar nuk e plotëson kriterin numër 3.1 dhe i mungon **njëri prej dy Arkitektëve nivelit master** të kërkuar sipas Dosjes së Tenderit, përkatësisht kërkesa **3.1: Një (1) Inxhinier i diplomuar i arkitekturës (ose Master)**.

Kjo vërtetohet edhe me vendimin nr. 2025/0006, të datës 17.03.2025, të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), ku kriteret të cilat nuk i plotëson ky operator janë të trajtuara në këtë vendim dhe është e qartë dhe e pakontestueshme se operatori nuk është në pajtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Bazuar në vendimin e OSHP-së me nr. 2025/0006, ku ne jemi OE ankues, kriteri numër 2 dhe kriteri numër 3 trajtohen si kritere të ndara, sipas dëshmive të dokumentuara dhe me kushte të veçanta për secilën kërkesë, ku decidivisht thotë:

“PSH gjatë shtjellimit në tërësi të dokumentacionin ka vërejtur se në DT, kanë qenë të parashtruara ndër të tjera edhe dy kërkesa të cilat kanë qenë të ndara njëra nga tjetra, e para është kërkuar Caktimi i Menaxherit të kontratë më saktisht Vendimi për caktimin e menaxherit të kontratës dhe e dyta kërkesë ka qenë lista e stafit profesional, prandaj PSH ka trajtuar, tek:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 : 1.Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkesa për LOT 1,2, 3 dhe 4 Kriteri numër 2. Caktimi i Menaxherit të kontratës Dëshmia e kërkuar dokumentare:Vendimi për përcaktimin e menaxherit të kontratës, i cili duhet të jetë Master ose Inxhinier i Arkitekturës ose i Ndërtimtarisë-Konstruktiv. Vendimi duhet të përmbajë të dhëna bazike mbi procedurën aplikuese (Emrin e Autoritetit, Emërtimin e procedurës, numrin e prokurimit). Menaxheri i kontratës duhet të prezantojë a. Diplomën universitare të noterizuar. b. Kontratën c punës (të nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). c. Dëshmi për përvojë të punës se paku 5 vile në fushën e trashëgimisë kulturore ose të punëve të ngjashme (të dëshmohen me CV të nënshkruar dhe me diplomë pas titullit Master ose Inxhinier), d. Së paku një referencë të punës në menaxhim të kontratave-mbikëqyrje të implementimit të projekteve të ngjashme.

2.Kapaciteti teknik dhe profesional:Kërkesa për LOT 1,2,3 dhe 4 Lista e stafit profesional 2.1 Një (1) inxhinier i diplomuar i arkitekturës (ose Master) 2.2. Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë konstruktiv (ose Master) 2.3 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (ose Master) drejtimi hidroteknik 2.4 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës (ose Master) 2.5 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i makinerisë (ose Master). Dëshmia e kërkuar dokumentare

: E gjithë lista e stafit të kërkuar në kërkesën numër 2 nga Autoriteti kontraktues duhet të kenë;a. Diploma universitare e noterizuar.b. Kontrata c punës (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE).c. Dëshmi për përvojë të punës se paku 5 vite për në fushën e trashëgimisë kulturore ose punë të ngjashme (të dëshmohet me CV c nënshkruar nga i angazhuari), përjashtimisht pikës 2.3, 2.4 dhe 2.5 ku përvoja e punës mund te jete minimumi 2 vite.d. Dëshmi qe secili prej tyre ka se paku një referencë të punës që ndërlidhet me njërën nga natyrat c punës në restaurim ose konservim ose renovime të objekteve të trashëgimisë kulturore, përjashtimisht pikave2.3, 2.4 dhe 2.5 ku nuk kërkohej dëshmi,e. Se paku njeri prej tyre i paraqitur në listën c stafit profesional duhet (c jenë (ë licencuar me licencë AI. Në rast të posedimit të Licencës AI, inxhinjei i arkitekturës duhet të prezantojë vetëni kopjen e noterizuar të licencës ose kopjen e noterizuar të vendimit të Bordit të Licencimit që është i licencuar në kategorinë A-1 dhe Kontratën me O.E të vulosur dhe nënshkruar nga të dyja palët.

Bazuar në përshkrimin e kërkesave të parashtruara në DT, konstatohet se kërkesat në DT kanë qenë të ndara sipas dëshmive të dokumentuara dhe me kushte te veçanta për secilën kërkesë. PSH vlerëson faktin se AK në kërkesat e parashtruara dëshmitë e kërkuara janë të specifikuara dhe të qartësuara në mënyrë të sakt, po ashtu PSH vlerëson faktin se AK ka zbatuar dispozitat ligjore të nenit 7 të L.P.P- së duke bërë përpilimit e kërkesave dhe specifikimeve teknike në mënyrë të drejtë dhe të njëjtat duke mos qenë diskriminuese dhe në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik.”

Në bazë të Vendimit të OSHP-së me nr. 2025/0006, kjo çështje është e qartësuar shumë mirë dhe ky operator nuk është në pajtim krriteret ne Dosjen e Tenderit, si dhe është në kundërshtim me këtë vendim (bashkangjitur gjeni vendimin). Kërkojmë nga OSHP, konfrom këtij vendimi të shqyrtohet kjo ankesë.

Megjithatë edhe Autoriteti Kontraktues është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi, pasi që neve si operator ekonomik për këtë çështje na ka eliminuar, ndërsa operatorin tjetër e ka favorizuar.

Siç edhe shihet në mendimin e ekspertizës nr. 2026/0006, AK ka potencuar se kriteri numër 2 dhe kriteri numër 3 janë të ndara, si dhe ka theksuar se Menaxheri i Kontratës nuk mund të merret njëkohësisht me çështjet e menaxhimit administrativ të kontratës dhe me mbikëqyrjen e punimeve në terren, të cilen e vërteton dhe vendimi OSHP-së 2025/0006. Ndërkohë në këtë procedurë paraprake, ne kishim të angazhuar dy arkitektë.

Absurdi i kësaj situatë ku është shpërblyer operatori i rekomanduar në këtë aktivitet, qëndron në faktin se ai ka të angazhuar vetëm një arkitekt.

Andaj, çdo shkallë që vendos ndryshe nga vendimi OSHP - së nr. 2025/0006 është në kundërshtim me këtë vendim dhe me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik, dhe neve si operator ekonomik, na cenohet e drejta konkurruese e barabartë

Ndër të tjera Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), lidhur me ankesat nr. 1000/25 dhe 1012/25, për këtë procedurë ka theksuar si në vijim:

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe **konsideron se pohimet ankimore të OE ankues janë të paqëndrueshme ashtu siç janë dhënë në konstatimin e panelit.**

Pra PSH pohimet ankimore të operatorëve ekonomikë ankues i ka parë si të paqëndrueshme, dhe AK duhet të ri-vlerësoj konform Parimeve Themelore të Prokurimit.

Andaj duke bazuar në Nenin 116.6 të LPP-se, **Një vendim i OSHP-së për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.**

Kërkojmë nga ju si ORGAN SHQYRTUES I PROKURIMIT, që të tregoni konsistencë në vendimmarrje dhe vetëm të mbani konsistencë ndaj vendimeve, perkatsisht vendimit tuaj nr.2025/0006, dhe me këtë vërtetohet përpërgjegjshmëria e OE “Eing Com” dhe “Froni 1”

Në OE “TONI O.P.” si palë me interes dhe ankuese në vendimin nr. 2025/0006, e kemi pranuar vendimin tuaj, meqenëse nuk kemi shfrytëzuar të drejtën e shkallëshmërisë që na lejon ligji. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, kërkojmë që së paku t’i përmbaheni vendimit tuaj, Në të kundërtën, ne do të jemi të diskriminuar për çështjen e njëjtë, nga i njëjti Panel Shqyrtues, brenda një afati kohor njëvjeçar.

Pretendimi 2. Në lidhje me shqyrtimin e ankesave nr. 1000/25 dhe 1012/25 për këtë procedurë, konsiderojmë se Eksperti Shqyrtues nuk e ka përpiluar raportin e tij duke u bazuar në faktet dhe argumentet, në gjendjen reale, në pretendimet ankimore të OE dhe në kërkesat e dosjes së tenderit.

Eksperti i ka vlerësuar pretendimet e OE si të bazuara dhe ka rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim.

Pretendimet ankimore i konsideron si të bazuara me arsyetimin se kriteret nuk kanë qenë të përpiluara si duhet nga AK dhe se kjo duhet të shkojë në dëm të palës, gjegjësisht të AK-së.

Si mund të konsiderohen të papërpiluara si duhet dy kriteret në Dosjen e Tenderit, kur aty kërkohet qartë:

- **Kriteri numër 2** (me dëshmi të dokumenteve dhe me kushte të veçanta për secilën kërkesë)
- **Kriteri numër 3** (me dëshmi të dokumenteve dhe me kushte të veçanta për secilën kërkesë)

Këto dy kriteret janë shumë mirë dhe qartë të përpiluara dhe nuk mund të pretendohet e kundërta.

Eksperti Shqyrtues ka interpretuar Ligjin mbi Marrëdhëniet dhe Detyrimet pa e kërkuar asnjëra palë ankuese, duke dalë kështu jashtë kompetencave ligjore “ultra vires”. Në ankesa të tjera, ligjet përveç LPP-së janë anashkaluar me arsyetimin se nuk është kompetencë e OSHP-së të interpretojë ligje të tjera. Në këtë kontekst, palët ankuese as nuk kanë pretenduar duke u bazuar në ligje të tjera, por vetëm në kriteret e dosjes së tenderit. Prandaj, nuk ka qenë e nevojshme një interpretim i tillë, i cili ka komprometuar tërë procesin e këtij aktiviteti.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, kërkojmë nga eksperti shqyrtues që, në mënyrë objektive dhe të paanshme, ta përpilojë raportin duke pasur për bazë vendimin e OSHP nr. 0006/2025.

Pretendimi 3. Menaxheria e Kontratës znj. Ilirjana Azizi Mejzini e emëruar nga operatori dhe e angazhuar me kontratë të rregullt, është në konflikt interesi me ju si AK – MKRS, pasi që gjatë periudhës nëntor 2022 – dhjetor 2023 ka qenë e punësuar dhe e angazhuar si Arkitekte në Divizionin e Menaxhimit të Integruar dhe Turizmit Kulturor. Këtë fakt e ka paraqitur edhe në CV-në e saj të nënshkruar:

Surname(s) / First name(s)	ILIRJANA AZIZI - MEJZINI
Address(es)	
Telephone(s)	
E-mail(s)	
Nationality(-ies)	Kosova
Date of birth	
Gender	Femer
Work experience	
Nentor 2022 – Dhjetor 2023	MKRS – Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve
Occupation or position held	Konsulente – Arkitekte ne Divizionin e Menaxhimit te Integruar dhe Turizmit Kulturor
Main activities and responsibilities	- Koordinator e Grupit ndërmëstrotor te MKRS (DTK, IKMM dhe QRTK e Prishtines), se bashku me OSCE dhe KK e Prishtines per Hartim te Planit te Menaxhimit per Hamamin e Madh te Prishtines, ne berthamen me te lashite urbane te Qendres Historike te Prishtines - Anetare e Komisioneve per Pranimi Teknik - vlerësim ne terren te punëve, nëse ishin te përfunduara sipas paramases se Planit per "Nderhyrje Restauruese / konservuese" ne disa shtopi, si e Destan Kabashit apo familjeve si: Dorambari, Sokoli, Bardhi dhe e shume aseteve arkitektuale te tjera te shpallura nen mbrojtje.
Name and address of employer	Sheshi "Nena Tereze" / Ish-ndertesa e Komitetit te Kosoves - Prishtine
Type of business or sector	DTK, Divizioni per Menaxhim te Integruar dhe Turizem Kulturor

Referuar periudhës sa ka qenë e punësuar si zyrtare në MKRS dhe kontratës së rregullt të lidhur me operatorin e rekomanduar “EING COM” Sh.P.K., me datë 06.01.2025, kjo çështje është në kundërshtim me paragrafin 1.3 të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, ku ndalohet që zyrtari, pas ushtrimit të detyrës, **“të përfaqësojë, ndihmojë ose këshillojë ndonjë person fizik ose juridik, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndonjë personi të afërm ose të besuar, në një konflikt ose marrëdhënie biznesi me institucionin, për detyrën që ai ka kryer ose që është në vazhdimësi të saj për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik”**.

Andaj, bazuar në faktin se njoftimi për kontratë për aktivitetin e prokurimit **“Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në Xhaminë e Çokut në Junik dhe Xhaminë e Orllanit në Podujevë”**, me numër të prokurimit: **207-25-7067-5-1-1**, është publikuar më datë 04.08.2025, znj. Ilirjana Azizi Mejzini nuk mund të angazhohet nga operatori në këtë aktivitet të prokurimit, për faktin se kemi konflikt interesi.

Ne si operator ekonomik “TONI” O.P., palë me interes në këtë procedurë, konsiderojmë se operatori i rekomanduar ka pasur avantazh të theksuar kundrejt nesh dhe konkurrencës.

Pretendimi 4. Operatori i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson Kriterin numër 4.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një listë të vulosur dhe të nënshkruar, ku duhet të përmbajë së paku 20 punëtorë profesional dhe mbështetës. Lista e paraqitur duhet të përmbajë të dhënat: Emri dhe mbiemri, të dhënat personale, eksperiencia dhe funksioni brenda kompanisë apo punët që do t'i kryejë në projekt:

4.1. Së paku 1 (një) - Teknik të ndërtimtarisë

4.2. Së paku 1 (një) – Teknik të elektroteknikës

4.3. Së paku 1 (një) - Mjeshtër/konservator druri (Licenca A2-2)

4.4. Së paku 1 (një) - Mjeshtër/konservator guri (Licenca A2-1)

4.5 Së paku 1 (një) - Konservues/Restaurues i materialeve të tjera ndërtimore sipas fushës specifike të specializuar si: metaleve, qelqit, llaçeve etj. (Licenca A2-3)

4.6. Së paku 10 punëtorë në punë të ndryshme, si p.sh. shtrues pllakash, suvatues, instalues, mjeshtër kulmi, llamarinë punues, saldues, etj.

4.7. Së paku 6 punëtorë fizik.

Stafi paraqitur sipas listës së bashkangjitur në ofertë dhe dokumentet e bashkangjitura janë në kundërthënie me njëra tjetrën dhe shfaqet tendencë sistematike nga operatori rekomanduar për devijim se në cilën pozitë janë të angazhuar stafi, me poshtë gjeni faktet dhe argumentet në të cilat angazhimi stafit dallon në listë, CV, kontratë:

1. Musa Bunjaku – Ne liste: Shtrues pllakash,
2. Fexhri Podvorica - Ne liste: Suvatues, Ne kontratë Puntor
3. Çlirim Tahiri - Ne liste: Instalues
4. Jakup Podvorica - Ne liste: Mjeshtër kulmi
5. Venhard Oruqi - Ne liste: Lllamarin punues, Ne kontratë Punetor-Shofer)
6. Fisnik Hyseni - Ne liste: Saldues
7. Visar Bajgora - Ne listë: Puntor Fizik, Ne CV Mjeshter i pergjithshem, ne Kontrate Mjeshter i pergjithshem
8. Fisnik Bisliri - Ne listë: Puntor Fizik, Ne kontrate Punetor, Ne CV Mjeshter (fasader, moler)
9. Muhamet Lahi - Ne listë: Puntor Fizik, Ne kontrate Mjeshter moler
10. Arsim Bllaca - Ne listë: Puntor Fizik, Ne kontrate Punetor
11. Qendrim Abdullahu – Ne listë: Puntor Fizik, Ne kontrate Punetor
12. Valmir Hyseni – Ne listë: Puntor Fizik, Ne kontrate Punetor
13. Kushtrim Muzaqi - Ne listë: Puntor Fizik

14. Samed Podvorica – Ne listë: Puntor Fizik, Ne kontrate Punetor

15. Hyzri Mehmeti - Ne listë: Puntor Fizik, Ne CV Saldues, ne Kontrate Mjeshter i pergjithshem

16. Rinor Ajeti – Ne listë: Puntor Fizik, Ne kontrate Punetor

17. Afrim Pervetica – Ne listë: Puntor Fizik, Ne kontrate Elektricit

Në të gjitha pikat e theksuara me ngjyrë, janë në kundërshtim profesioni, pozita, të angazhuar për këtë aktivitet të prokurimit, dhe referuar procedurës paraprake Teatrit Adriana, kemi të bëjmë me të njëjtën çështje të angazhimeve të stafit, ku i mungon stafi dhe nuk është në pajtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Sa i përket z. Fexhri Podvorica, i cili në listë është paraqitur si suvatues, ndërsa në kontratë figuron si punëtor, shtrohet pyetja se si është sqaruar kjo pikë nga operatori?

Gjatë ekzekutimit të projektit i njëjti nuk mund të angazhohet si suvatues, pasi që me kontratë është i angazhuar si punëtor dhe rrjedhimisht nuk ka asnjë përgjegjësi kontraktuale dhe ligjore për t'u angazhuar si suvatues. Kjo pikë nuk plotësohet nga operatori dhe nuk mund të plotësohet as përmes sqarimit, cdo tendecë për plotësim është në kundërshtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së.

Sa i përket z. Venhard Oruqi, i cili në listë është paraqitur si Lllamarin punues, ndërsa në kontratë figuron si Punëtor-Shofer, shtrohet pyetja se si është sqaruar kjo pikë nga operatori?

Gjatë ekzekutimit të projektit i njëjti nuk mund të angazhohet si Lllamarin punues, pasi që me kontratë është i angazhuar si Punëtor-Shofer, dhe rrjedhimisht i punësuar nuk ka asnjë përgjegjësi kontraktuale dhe ligjore për t'u angazhuar si Lllamarin punues. Kjo pikë nuk plotësohet nga operatori, pasi që nuk mund të plotësohet as edhe nëse është kërkuar sqarim lidhur me këtë pikë, për shkak se dilet jashtë kontekstit të kërkesës dhe nuk është e mundur që një shofer i angazhuar të ushtrojë profesionin e Lllamarin-punuesit. Dhe cdo sqarim tjetër është në kundërshtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së nga AK dhe OE. Lllamarine punuesi mungon dhe operatori është i papërgjegjshëm në këtë pikë.

Sa i përket z. Visar Bajgora, i cili në listë është paraqitur si Punëtor fizik, ndërsa në kontratë dhe në CV figuron si Mjeshtër i përgjithshëm, shtrohet pyetja se si është sqaruar kjo pikë nga operatori dhe për cilën pozitë është konsideruar i njëjti?

Sa i përket z. Fisnik Bislimi, i cili në listë është paraqitur si Punëtor fizik, në kontratë është angazhuar si Punëtor, ndërsa në ankesë CV e bashkangjitur figuron si Mjeshtër (fasader, moler), shtrohet pyetja se si është sqaruar kjo pikë nga operatori? Në këtë rast kemi tri

kontradikta ndërmjet dokumenteve, andaj lind pyetja se si e ka marrë për bazë këtë pikë Komisioni i Vlerësimit dhe cilin kriter e përmbush realisht.

Sa i përket z. Muhamet Lahi, i cili në listë është paraqitur si Punëtor fizik, ndërsa në kontratë figuron si Mjeshtër moler, shtrohet pyetja se si është sqaruar kjo pikë nga operatori dhe për cilën pozitë është vendosur i njëjti?

Sa i përket z. Hyzri Mehmeti, i cili në listë është paraqitur si Punëtor fizik, në kontratë figuron si Mjeshtër i përgjithshëm, ndërsa në ankesë CV si Saldues, kemi tri kontradikta të qarta ndërmjet dokumenteve (shih deshmite e bashkangjitura). Në këtë rast kemi tri kontradikta ndërmjet dokumenteve, andaj lind pyetja se si e ka marrë për bazë këtë pikë Komisioni i Vlerësimit dhe cilin kriter e përmbush realisht.

Sa i përket z. Afrim Pervetica, i cili në listë është paraqitur si Punëtor fizik, ndërsa në kontratë figuron si Elektricitist, shtrohet pyetja se si është sqaruar kjo pikë nga operatori dhe për cilën pozitë është vendosur i njëjti (shih deshmite e bashkangjitura).

Kerkojme të verifikojmë dhe qartësojmë në mënyrë transparente dhe të drejtë konform LPP-se dhe në këtë pikë operatori është administrativisht i përgjegjshëm.

Pretendimi 5. Operatori i rekomanduar për kontratë “EING COM Sh.P.K.” ka paraqitur kontratën e punës për stafin e angazhuar në kundërshtim me nenin 57 (Paga minimale) të Ligjit nr. 03/L-212 për Punën. Konkretisht në kontratën e punës me orar të plotë 40 orë në javë me z. Visar Bajgora, në nenin 4 është përcaktuar paga mujore në shumën prej 250 euro, me datë lidhjeje 01.03.2021, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Rrjedhimisht, ekziston dyshimi i bazuar se kjo kontratë mund të jetë edhe kontratë fiktive, për shkak se është në kundërshtim me Ligjin e Punës dhe nuk është i deklaruar në ATK (shih kontratën bashkangjitur)

Po ashtu kontrata e punës me orar të plotë 40 orë në javë me z. Fisnik Bislami është në kundërshtim me nenin 57 (Paga minimale) të Ligjit nr. 03/L-212 për Punën, pasi që në nenin 4 të kontratës është përcaktuar paga mujore në shumën prej 300 euro, me datë lidhjeje 01.04.2021, gjithashtu në kundërshtim me Ligjin në fuqi. Edhe në këtë rast, ekziston dyshimi i arsyeshëm se kemi të bëjmë me kontratë fiktive, përderisa përmbajtja e saj bie ndesh me dispozitat e Ligjit të Punës dhe nuk është i deklaruar në ATK me kontratë të rregullt (shih kontratën bashkangjitur), si referencë kemi dhjetëra vendime të OSHP-së.

Pasi që ekspertët ka interpretuar Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve në shqyrtimin e ankesave nr. 1000/2025 dhe 1012/2025, kërkojmë që edhe në këtë ankesë ta ketë parasysh nenin 50.1 të këtij ligji, i cili thotë: “Kontrata fiktive nuk ka efekt juridik ndërmjet palëve kontraktuese”. Në mënyrë që të sigurohet trajtim i barabartë për të gjitha

palët, në përputhje me parimin e barazisë para ligjit, paanshmërisë dhe objektivitetit në shqyrtimin e çështjes.

Pretendimi 6. Sa i përket operatorit ekonomik "FRONI 1" Sh.P.K., i eliminuar për shkak se nuk e plotëson kriterin numër 7, ne pajtohemi me këtë pikë. Por, sa i përket stafit profesional, ky operator nuk ka angazhuar staf të mjaftueshëm sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit dhe është në të njëjtën situatë me operatorin ekonomik "EING COM" Sh.P.K., dhe të dy janë të papërgjegjshëm në këtë pikë, sipas pretendimeve paraprase. Konkretisht operatorit "FRONI 1" Sh.P.K. i mungon një Inxhinier i ndërtimtarisë – konstruktiv, sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Por vetë operatori "FRONI 1" është pajtuar "De facto" me arsyet e eliminimit në vendimin e datës 01.10.2025, ku eksperti shqyrtues e konstaton dhe thotë:

Pretendimi nr.2

OE potencon se pajtohet me eliminim e OE EING nga ana e AK-së, mirëpo jo edhe me eliminim e vet.

11

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "FRONI 1" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në Xhaminë e Çokut në Junik dhe Xhaminë e Orllanit në Podujevë" me numër të prokurimit: "207-25-7067-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

Sqarojmë se arsyeja e eliminimit të OE EING është e njëjtë me arsyen e eliminimit të OE ankues Froni 1, andaj e kemi të paqartë se si mund të pretendohet se OE EING është i papërgjegjshëm përderisa OE ankues Froni 1 është vet në situatë të njëjtë.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Këtë ka mundur ta pranojë për shkak se ka qenë palë pjesëmarrëse në aktivitetin që ka të bëjë me shqyrtimin e ankesës nr. 0006/2025, dhe i njëjti ka qenë i informuar.

Pretendimi 7. Sa i përket arsyes së eliminimit tonë janë dhënë arsye e njëjta si në vendimin e datës 15.09.2025, të cilën arsye e kemi kundërshtuar në atë periudhë, dhe të njëjtat janë marrë si të bazuara. Ndërsa përsëri në vendimin e datës 22.01.2026, ato arsyet janë përdorur si shabllon për të na eliminuar, pa analizuar kontratat tona dhe të stafit:

Tenderi i juaj është ofertë administrativisht e papërgjegjshme sepse :

X Ju nuk keni plotësuar kriterin numër 7.;

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

në kërkesën e Dosjes së tenderit - **Kriteri numër 7. O.E. duhet të siguroj nuk ka me shume se tri kontrata aktive me MKRS-ne të natyrës së njëjtë, respektivisht në planin dinamik të punës nuk mund të jetë i njëjti arkitekt i licencuar ose mjeshtër i licencuar i angazhuar në më shumë se tri kontrata tjera të natyrës së njëjtë. Dhe 7. Nëse O.E. konkuron në disa projekte restauruese në planin dinamik të punës nuk mund të figurojë i njëjti arkitekt i licencuar, ose mjeshtër i licencuar në më tepër se tri kontrata i angazhuar në të njëjtën kohë (njëjtat data kalendarike).** Ju nuk e plotësoni këtë kriter për arsye se keni të angazhuar Mjeshtër me Licencë A2-3 në më tepër se tre kontrata. Mjeshtër me Licencë A2-3(z. Sh.B.) është i angazhuar në këto kontrata: 1. Konservimi Restaurimi i Kullës së Ymer Pogës - Rugovë e Hasit, 2. Intervenime emergjente në objektet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit, 3. Restaurimi dhe Konservimi i Kullës së Astrit Kryeziut (Tosun Beut), 4. Ndërhyrje konservuese dhe restauruese në Shtëpinë e Ymer Elshanit në Drenas 5. Restaurimi dhe Konservimi - Kulla e Astrit Kryeziut - Tosun Beut në Gjakovë.

Në lidhje me kontratën **“Konservimi Restaurimi i Kullës së Ymer Pogës - Rugovë e Hasit”** kjo kontratë ka përfunduar me date 30.09.2025, si deshmi e keni të bashkangjitur raportin e perfundimit të puneve nga komisioni për pranimin teknik.

Në këtë kontekst, kriteri nr. 7 thotë qartë: “respektivisht në planin dinamik të punës” nuk mund të jete i angazhuar.

Në lidhje me kontratën **“Intervenime emergjente në objektet e trashëgimisë kulturore në rajonin e Prizrenit”** kjo kontratë ka përfunduar me datë 05.06.2025. Raporti i komisionit pranues është dorëzuar dhe bashkëngjitur edhe në listen e kontratave dhe pranimeve teknike në platforme. Meqenëse kontrata ka përfunduar nuk mund të konsiderohet si aktive. Si dëshmi bashkëngjitur kësaj ankese gjeni raportin e komisionit pranues.

Në lidhje me kontratën **“Ndërhyrje konservuese dhe restauruese në Shtëpinë e Ymer Elshanit në Drenas”** për këtë projekt nuk është kërkuar fare angazhimi i një personi të licencuar me kategorinë A2-3. Për këtë projekt nuk e kemi të angazhuar të lartecekurin me A2-3. Si dëshmi mund të gjeni në dosjen e tenderit se një kërkesë e tillë nuk është kërkuar, po ashtu kjo vërtetohet edhe në listen e stafit mbështetës që e kemi ngarkuar në platformë.

Në lidhje me kontratën **“Restaurimi dhe Konservimi i Kullës së Astrit Kryeziut (Tosun Beut)”** punimet në këtë kontratë tashmë kanë përfunduar. Kërkesa për pranim teknik është dorëzuar tek organi mbikëqyrës me datë 12 Djetor 2025. Për shkak të zvarritjes së procedurave administrative, pranimi teknik ende nuk është realizuar, por që gjatë javes do të përfundojë, dhe rrjedhimisht kjo nënkupton se angazhimi i lartecekurit në këtë kontratë ka përfunduar tërësisht. Në këtë kontekst, kriteri nr. 7 thotë qartë: “respektivisht në planin dinamik të punës” nuk mund të jete i angazhuar. Bashkangjitur gjeni dhe deshmitë e kërkesës.

Duke u bazuar në kriterin nr. 7, si dhe në përgjigjet që vetë ju AK ka dhënë:

këtë kërkesë si dhe kërkesa të tjera të operatorëve që mund të vijnë në të ardhmen DTK sqaron se stafi i licencuar i kërkuar sipas dosjes së tenderit, nuk mund të jete i angazhuar në më shumë se tri projekte në të njëjtën kohë, pra, ky kriter nuk ka të bëjë me projektet aktive të operatorit ekonomik, por të stafit të tij.

thuhet qartë se kriteri ka të bëjë me angazhimin e stafit në jo më shumë se tri kontrata aktive, e jo me kontratat e operatorit ekonomik në përgjithësi.

Andaj, i lartë cekuri tashmë nuk është i angazhuar në asnjë kontratë aktive të natyrës së ngjajshme.

Në kërkesën tonë për rishqyrtim të paraqitur pranë Autoritetit Kontraktues, shihet që nuk janë trajtuar fare pikat tona të cilat i kemi elaboruar, dhe në mënyrë arbitrare është marrë vendim i pajustificuar për refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim, pa dhënë arsyetim të plotë dhe transparent.

Kërkojmë nga ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT -OSHP që të marrë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e OE : “TONI” O.P. Lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në Xhaminë e Çokut në Junik dhe Xhaminë e Orllanit në Podujevë - për LOT II Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në Xhaminë e Orllanit në Podujevë** me nr. të prokurimit: **207-25-7067-5-1-1** dhe Nr i brendshëm: **207-25-086-511**.

II. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së Lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në Xhaminë e Çokut në Junik dhe Xhaminë e Orllanit në Podujevë - për LOT II Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në Xhaminë e Orllanit në Podujevë** me nr. të prokurimit: **207-25-7067-5-1-1** dhe Nr i brendshëm: **207-25-086-511** dhe lënda kthehet në Rivlerësim për LOT 2 .

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Ne OE kemi shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit, ofertave dhe pjesëve tjera të cilat ndërlidhet me këtë procedurë të prokurimit, shpenzimet për sigurimin e ofertës, ngecje në angazhim të stafit në projekt, koha e humbur.

Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo material e i cili shtrihet edhe në raport me LMD neni 136, 137 duke mos u kufizuar edhe edhe në dëmtimin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*